



Fakulteti i
Arkitekturës
dhe Urbanistikës

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

MASTER SHKENCOR I INTEGRUAR

Arkitekturë Urbanist

Program i integruar i studimeve të ciklit të dytë i realizuar me 300 kredite (ECTS) me kohëzgjatje normale 5 vite akademike. Niveli 7 Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

Studimet e integruara të ciklit të dytë, Master i Shkencave në Arkitekturë - Urbanist, përfshijnë një sërë instrumentash teorike në programin e studimit për të mundësuar tek studentët marrjen e bazave të nevojshme shkencore, aftësi metodike kërkimore dhe kualifikimin profesional në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës.

Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Urbanistikës. Objektivi i përgjithshëm i DU-së është të kontribuojë përmes veprimtarive të veta shkencore, të formojë profesionistë dhe ekspertë të rinj të fushave të arkitekturës dhe urbanistikës, të kualifikuar dhe të përshtatshëm për tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera të zhvilluara.



KUSHTET E HYRJES NË PROGRAMIN E STUDIMIT

Diplomë e shkollës së mesme 3-4 vjeçare dhe Matura Shtetërore Programi i studimit, në arkitekturë - urbanist, ka si objektivi kryesor formimin e profesionistëve të aftë të integrohen në tregun e punës, duke shfaqur njohuri të plota në ballafaqimin me projektet arkitektonike, ndërhyrjet urbane dhe zhvillimet territoriale.



MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma e ciklit të dytë "Master i Shkencave" i jep mundësinë mbajtësit të saj për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë (studime doktorale).



MUNDËSI PUNËSIMI

Formimi në Master Shkencor në Arkitekturë - Urbanist, kërkon të rrisë aftësitë sintetizuese, kreative dhe komunikuese të kandidatit, në shërbim të ndërhyrjeve arkitekto-urbane. Të diplomuarit mund të punësohet si projektues arkitekt dhe urbanist (profesion i rregulluar) në ndërmarrje/organizata publike apo private dhe të pajisen me Licencën profesionale, sipas specifikave të legjislatonin përkatës.

www.fau.edu.al



Rruga Muhamet Gjollësja; Nr.54; Tiranë
Tel: 00355 42229045 | Email: info@fau.edu.al

Departamenti i Urbanistikës



- BAZAT E PROJEKTIMIT ARKITEKTONIK
- BAZAT E PROJEKTIMIT URBAN DHE ELEMENTE PEIZAZHI
- FILOZOFI DHE ANTROPOLOGJI QYTETI
- LEGJISLACION ARKITEKTONIK E URBAN
- GRAFIKË ARKITEKTONIKE
- STUDIO PROJEKTIMI ARKITEKTONIK
- ANALIZË QYTETI DHE TERRITORI
- PROJEKTIM URBANISTIK
- KOMPOZICION, ANALIZË FORME DHE HAPËSIRE
- PLANIFIKIM TERRITORI
- PROJEKTIMI I MJEDISIT TË NDËRTUAR
- TRANSPORT DHE INFRASTRUKTURË
- RIGJENERIM URBAN